

Shoqata „Greikoci“

Raporti vjetor 2023

Ossingen ZH (Zvicër), 31 dhjetor 2023

Hyrje

Me rastin e mbylljes së vitit 2023, shoqata “Greikoci” falënderon të gjithë anëtarët, sponsorët dhe kontribuuesit, për mbështetjen e tyre financiare dhe morale përgjatë këtij viti. Njëkohësisht falënderon tre punëtorët, të cilët janë të angazhuar në Greikoc për ta mundësuar një ambient sa më të pastër, qysh nga viti 2016.

Njëkohësisht njoftoheni që rrënimi i parkut “Dëshmorët”, i cili është realizuar nga shoqata “Greikoci” në vitin 2016 dhe kishte një vlerë mbi 15 000 euro, ishte jo i koordinuar dhe i njëanshëm nga ana e kryesisë së fshatit dhe Organizatës së Veteranëve të fshatit. Ne, si shoqatë dhe investitor jemi ankuar tek autoritetet përkatëse, që ky park të rindërtohet në pjesën, ku ishte lapidari i mëhershëm. Deri më tani nuk kemi marrë një përgjigje nga zyrtarët komunalë se a do të rindërtohet ky park. Ne si kryesi jemi të zhgënjyer prej autoriteteve kompetente për këto veprime.

Në vijim ju pasqyrojmë disa projekte, të cilat janë realizuar gjatë vitit 2023.

Lektura për nxënësit e SHFMU Greikoc [shkurt 2023]

Me rastin e 15 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës, shoqata “Greikoci” dhuroi nga një lekturë për nxënësit e SHFMU në Greikoc që nga klasat 1 deri 5. Gjithsej u dhuruan 170 lektura dhe kapnin koston prej 312.50 euro. Shoqata “Greikoci” falënderon mr. Fikret Ramaj për organizimin e këtij aksioni.



Donacion për shtatoren e Sali (Shaban) Rexhaj [shkurt 2023]

Me kërkesën e Këshillit Organizativ për rregullimin e shtatores së Sali Shabanit (Rexhaj) në Korishë, shoqata “Greikoci” ka vendosur të ndajë 500 euro për këtë iniciativë. Inaugurimi i shtatores u bë më 13 maj 2023 në Korishë të komunës së Prizrenit.



Dhurata për fëmijë për Fitër Bajram [prill 2023]

Për së dyti herë, shoqata “Greikoci” përgatiti dhurata për fëmijët e fshatit me rastin e Fiter Bajramit. Ky gjest u mirëprit nga i gjithë komuniteti i fshatit. Brenda këtij aksioni u shpërndanë 150 dhurata për fëmijët e fshatit.



Iftari 2023 (prill 2023)

Shoqata “Greikoci” organizoi iftar publik për burra dhe për gra disa vite me radhë. Kjo traditë shërben për t’u takuar banorët e Greikocit, si dhe është mirëpritur shumë nga gjinia femërore.



500 libra për bibliotekën e shkollës së Greikocit [prill 2023]

Shoqata “Greikoci” dhuroi mbi 500 libra për bibliotekën e SHFMU në Greikoc. Urojmë që nxënësit të përfitojnë maksimalisht nga këto libra. Ju njoftojmë se drejtorja e shkollës refuzoi pranim - dorëzimin zyrtar..

Grill dhe takim me anëtarë [maj 2023]

Më 14 maj 2023, shoqata “Greikoci” organizoi një takim me anëtarë në Winterthur të Zvicrës, ku pas mbledhjes së rregullt të anëtarësisë ishte organizuar një skarë për familjarët e anëtarëve të shoqatës “Greikoci”.



Kampi veror [qershor - korrik 2023]

Ju njoftojmë se shoqata “Greikoci” ka pasur për të organizuar këtë verë një “summer kamp”, ku fëmijët që vijnë shkollën fillore do t’ju mundësohej qasja falas në këtë kamp. Aktivitetet e parapara ishin: si gjuhë gjermane, gjuhë angleze, kurse për muzikë, kurse për teatër, aktivitete sportive dhe ekskursione për dy javë gjatë pushimeve verore. Kostot e organizimit do t’i mbulonte shoqata “Greikoci”. Për fat të keq nuk arritëm marrëveshje me drejtorin e SHFMU në Greikoc, pasi që ky na dikton dhe na tregon se si duhet të duken ligjëruesit.

Urojmë që së shpejti do të krijohen kushte më të përshtatshme për mbajtjen e një summer campi për fëmijët e Greikocit.

Mirëmbajtja e fshatit [janar - dhjetor 2023]

Qysh nga viti 2016 shoqata “Greikoci” ka angazhuar dy punëtorë që merren me mirëmbajtjen e fshatit Greikoc dhe hapjen e varrezave për banorët të Greikocit. Mirëmbajtja e fshatit i kushton shoqatës diku rreth 50% të mjeteve poseduese për një vit.

Stilolaps & varëse aromatike [dhjetor 2023]

Shoqata Greikoci si shej falenderimi ka vendosur t’ua dhuroi antarëve, kontributorëve dhe sponsorëve nga një varëse aromatike për vetura dhe nga një stilolaps me motive të shoqatës.



Rreth shoqatës „Greikoci“:

Themelimi:	17 maj 2015
Selia:	Ossingen ZH – Zvicër
Numri i anëtarëve:	mbi 230
Kryetar:	Rexhep Neziraj (+41 79 489 49 92)
Webfaqja:	www.greikoci.ch
Kontakt:	shoqata_greikoci@gmx.ch
Facebook:	Shoqata Greikoci

Synimet për vitin 2024

Për vitin 2024, kryesia e Shoqatës ka vendosur që të vazhdojë fokusin kryesor për mirëmbajtjen e ambientit të fshatit Greikoc. Projektet konkrete do të pasojnë gjatë pranverës së vitit 2024.